


Nr. i protokollit 1796711

Data: 12.11.2024



RREGULLORE PËR AVANCIM TË STAFIT AKADEMIK NË UNI – UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE

Nëntor, 2024

Mbështetur në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 19 të Statutit të UNI – Universum International College, Këshilli Akademik, miraton këtë:

RREGULLORE PËR AVANCIMIN E STAFIT AKADEMIK NË UNI - UNIVERSUM INTERNATIONAL COLLEGE

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për avancimin e stafit akademik në titujt e mëposhtëm:

1. Ligjërues
2. Profesor Asistent
3. Profesor i Asociuar
4. Profesor i Rregullt

E drejta për të aplikuar për marrjen e titullit akademik u takon të gjithë anëtarëve të rregullit të stafit akademik, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 2

Kushtet e përgjithshme për emërim dhe avancim

1. **Përputhja me Ligjin dhe Rregulloren:** Titujt akademikë në UNI – Universum International College jepen në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.
2. **Kualifikimet dhe Përvoja:** Kushtet për emërim dhe avancim në cilindo titull akademik përfshijnë kualifikimet përkatëse dhe përvojën e nevojshme për pozicionin përkatës.
3. **Vlerësimi i Kualifikimeve:** Një komponent vendimtar në vlerësimin e kualifikimeve të kandidatit/es janë publikimet shkencore të tij/saj në revista ndërkombëtare, dhe specifikiisht në platformat Web of Science dhe Scopus, përfshirë edhe botimet vendore të indeksuara në këto platforma.
4. **Relevanca e Publikimeve:** Të gjitha publikimet e kandidatit/es, përfshirë artikujt shkencorë, monografitë dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore, duhet të jenë në fushën përkatëse për të cilën kërkohet emërimi, rizgjedhja ose avancimi i personelit akademik.
5. **Përmbushja e Kritereve Minimale:** Kandidati/ja duhet të përmbushë kriteret minimale të përcaktuara në këtë rregullore për t'u kualifikuar për emërim ose avancim.

Neni 3

Fitimi i titullit Ligjërues

1. Për titullin Ligjërues, kandidati/ja duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në drejtimin përkatës.
 - 1.2. Të ketë së paku pesë vjet përvojë të evidentuar profesionale në fushën e studimit/programit.
2. Marrja e këtij titulli, përveç përmbushjes së kritereve të përcaktuara, duhet të jetë i shoqëruar me një vlerësim pozitiv nga komisioni përkatës.

Neni 4

Fitimi i titullit Profesor Asistent

1. Për titullin e profesorit asistent, kandidati/ja duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Dëshmi e fitimit të gradës së nivelit të Doktoratës (për stafin i cili ka fituar titullin shkencor jashtë Republikës së Kosovës kërkohet nostrifikimi nga NARIC);
 - 1.2. Të ketë me së paku dy (2) punime të publikuara dhe të shqyrtuara në revista ndërkombëtare.
 - 1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie duke prezantuar një portfolio të punës së vet profesionale që përfshin një deklaratë të filozofisë së mësimdhënies.
2. Marrja e këtij titulli, përveç përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, duhet të jetë i shoqëruar me një vlerësim pozitiv nga komisioni përkatës.

Neni 5

Fitimi i titullit Profesor i Asociuar

1. Për titullin e profesorit të asociuar, kandidati/ja duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.2. Dëshmi e fitimit të gradës së nivelit të Doktoratës (për stafin i cili ka fituar titullin shkencor jashtë Republikës së Kosovës kërkohet nostrifikimi nga NARIC);
 - 1.3. Të ketë të paktën një kapitull të zgjedhur të botuar në një tekst të publikuar nga shtëpi botuese kredibile ndërkombëtare ose një libër për përdorim të studentëve ose monografi që nuk mund të jetë punimi i doktoratës;
 - 1.4. Të ketë numër të publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore me së paku tri (3) punime të publikuara dhe të shqyrtuara në revista ndërkombëtare, të indeksuara në platformat Web of Science dhe Scopus si autor i parë ose korrespondent, nga të cilat së paku një (1) si autor i parë;
 - 1.5. Të tregojë aftësi për mësimdhënie sipas sistemit të vlerësimit dhe menaxhimit të performancës së personelit akademik brenda institucionit, duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët.
2. Marrja e këtij titulli, përveç përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, duhet të jetë i shoqëruar me një vlerësim pozitiv nga komisioni përkatës.

Neni 6

Profesor i rregullt

1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Dëshmi e fitimit të gradës së nivelit të Doktoratës (për stafin i cili ka fituar titullin shkencor jashtë Republikës së Kosovës kërkohet nostrifikimi nga NARIC);
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndët, që dëshmohet me:
 - 1.2.1. Të ketë të paktën një kapitull të zgjedhur të botuar në një tekst të publikuar nga shtëpi botuese kredibile ndërkombëtare pas thirrjes së fundit ose një libër për përdorim të studentëve ose monografi, që nuk mund të jetë punimi i doktoratës ose patentë, pas thirrjes së fundit;
 - 1.2.2. Të ketë numër të publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore të indeksuara në platformat Web of Science dhe Scopus, me së paku katër (4) punime, të publikuara pas emërimit në titullin paraparak, si autor i parë ose korrespondent, nga të cilat së paku dy (2) si autor i parë;
 - 1.2.3. Pjesëmarrje e rregullt ose periodike në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - 1.2.4. Përvojë udhëheqjeje ose anëtar në projekte, si anëtar i grupit hulumtues të projekteve akademike/shkencore apo menaxher i një projekti me financim të jashtëm për institucionin;
 - 1.2.5. Të tregojë aftësi për mësimdhënie sipas sistemit të menaxhimit dhe vlerësimit të performancës, duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët;
 - 1.2.6. Mentorim i suksesshëm i së paku tri (3) temave master;
 - 1.2.7. Të ketë dëshmuar aftësi udhëheqjeje brenda institucionit, siç janë ushtrimi i funksioneve menaxheriale ose udhëheqje të komisioneve të përhershme ose të përkohshme në nivel të institucionit përfshirë komisionet vlerësuese për punime akademike.
2. Marrja e këtij titulli, përveç përmbushjes së kriterëve të përcaktuara, duhet të jetë i shoqëruar me një vlerësim pozitiv nga komisioni përkatës.

Neni 7 Procedura

1. **Dorëzimi i Propozimeve nga Shkollat:** Shkollat brenda UNI – Universum International College, në përputhje me kërkesat e programeve përkatëse, i dorëzojnë propozimet e arsyetuara tek Zëvendës Presidenti për Çështje Akademike/Rektori/ja.
2. **Shqyrtimi i Propozimeve:** Zëvendës Presidenti për Çështje Akademike/Rektori/ja shqyrton propozimet e paraqitura nga shkollat dhe i procedon për miratim tek Këshilli Akademik të institucionit.
3. **Shpallja e Konkursit:** Bazuar në propozimet e miratuara, Këshilli Akademik shpall konkursin për zgjedhjen ose avancimin e personelit akademik.
4. **Koha e Shpalljes së Konkursit:** Konkursi shpallet përpara fillimit të vitit akademik, por mund të shpallet edhe në raste të tjera kur nevojitet.
5. **Përmbajtja e Konkursit:** Konkursi përcakton kriteret e avancimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe periudhën e hapur të konkursit.
6. **Publikimi i Konkursit:** Konkursi publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe mbetet i hapur për 15 ditë kalendarike nga data e publikimit.
7. **Dorëzimi i Dokumentacionit:** Dokumentacioni përkatës duhet të dorëzohet si në formë fizike, ashtu edhe në formë elektronike, pranë shkollës përkatëse.
8. **Dokumentacion i Pplotë:** Dokumentacioni i pplotë ose i dorëzuar pas afatit të përcaktuar nuk do të merret në shqyrtim.
9. **Detyrimi për Aplikim:** Të gjithë anëtarët e stafit akademik janë të detyruar të aplikojnë për titull akademik dhe do t'i nënshtrohen vlerësimit nga komisioni.

Neni 8

Emërimi dhe përbërja e Komisionit Vlerësues për Avancimin e Personelit Akademik në UNI – Universum International College

1. **Emërimi i Komisionit Vlerësues:** Komisioni Vlerësues për Avancimin e Personelit Akademik në UNI – Universum International College emërohet me vendim të Zëvendës Presidentit për Çështje Akademike ose Rektorit/es.
2. **Përbërja e Komisionit:** Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë me ekspertizë në fushën përkatëse të kandidatit/es, duke garantuar vlerësim të drejtë dhe të saktë të kualifikimeve dhe arritjeve të kandidatit/es.
3. **Anëtarë të Jashtëm:** Komisioni mund të përfshijë edhe anëtarë të jashtëm me ekspertizë specifike, të cilët mund të kontribuojnë në vlerësimin objektiv dhe të pavarur të kandidaturave.
4. **Përfaqësuesi i Burimeve Njerëzore:** Një përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të institucionit shërben si anëtar i përhershëm i Komisionit, me rol këshillues, por pa të drejtë vote.
5. **Zëvendësimi i Anëtarëve:** Zëvendës Presidenti për Çështje Akademike ose Rektori/ja ka të drejtën të zëvendësojë anëtarët e Komisionit, përkohësisht ose përhershëm, kur kjo është e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë dhe paanshmërinë e procesit të vlerësimit.
6. **Deklarimi i Konfliktit të Interesit:** Nëse një anëtar i Komisionit ka një konflikt interesi me kandidatin/en, ai/ajo është i/e detyruar të tërhiqet nga procesi i vlerësimit dhe votimit për të siguruar një vendimarrje të paanshme dhe transparente.

Neni 9

Vlerësimi dhe Vendimi i Komisionit Vlerësues për Avancimin e Personelit Akademik në UNI – Universum Internatioanl College

1. Komisioni Vlerësues merr vendimet për avancimin e personelit akademik me shumicën absolute të votave të anëtarëve të tij, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent.
2. **Kriteret e vlerësimit të stafit përfshijnë:**
 - **Vlerësimi nga Studentët:** Çdo anëtar i stafit do të vlerësohet nga studentët përmes anketave të rregullta të vlerësimit të mësimdhënies. Ky vlerësim do të përfshijë aspekte si cilësia e përgatitjes së lëndëve, qartësia e mësimdhënies, dhe përkushtimi ndaj studentëve.
 - **Vlerësimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë:** Një përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe një nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë do të vlerësojë përputhjen e performancës me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kontratën e punës (vlerësimi bazuar në KPI).
 - **Vlerësimi i Publikimeve Shkencore:** Kualifikimi shkencor do të vlerësohet bazuar në publikimet në revista të indeksuara ndërkombëtare, kontribute në konferenca shkencore, dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore të financuara.
 - **Vlerësimi nga Komisioni për Avancimin e Stafit Akademik:** Komisioni do të shqyrtojë plotësimin e kriterëve të avancimit, përfshirë rezultatet nga vlerësimi nga studentët, kërkimet shkencore, dhe vlerësimet nga Resurset Njerëzore dhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë.
3. Çdo kandidat/e që kalon me sukses procesin e avancimit, pajiset me certifikatën për titullin e ri të fituar. Certifikata do të dorëzohet në një ceremoni të posaçme për certifikimet e avancimit akademik të personelit të UNI – Universum International College.
4. Procesi i certifikimit dhe i dorëzimit të titujve të fituar përfshin një prezantim të arritjeve të kandidatit/es, duke vlerësuar kontributin e tij/saj në zhvillimin akademik dhe shkencor të institucionit.

Neni 10

Njohja e titujve të fituar më parë në institucione tjera

1. Institucioni bën ekuivalentimin e titujve akademikë të fituar nga kandidatët në institucione të tjera, duke ndjekur kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, si dhe standardet e përcaktuara nga organet e akreditimit në Kosovë.
2. Kandidati paraqet aplikimin për ekuivalentimin e titullit akademik, duke përfshirë dokumentacionin e nevojshëm dhe dëshmitë për arritjet e tij/saj, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Komisioni për ekuivalentimin e titujve shqyrton aplikimin dhe vendos për njohjen ose refuzimin e titullit brenda një periudhe të caktuar, jo më shumë se 30 ditë pune nga data e aplikimit.
4. Në rast të miratimit, kandidati i lëshohet certifikata e ekuivalentimit të titullit akademik, e cila është e vlefshme brenda institucionit dhe për qëllime të tjera profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi.


Neni 11


E drejta e ankesës

1. **E Drejta për Ankimim:** Çdo kandidat ka të drejtën të ankimojë vendimin e marrë lidhur me kërkesën e tij/saj për një titull akademik brenda shtatë (7) ditëve nga data e shpalljes së vendimit.
2. **Shqyrtimi i Ankesave:** Vendimi i Komisionit Vlerësues për Avancimin e Personelit Akademik të UNI – Universum International College shqyrtohet brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të afatit të ankimimit nga Komisioni i Ankesave.
3. **Përbërja e Komisionit të Ankesave:** Komisioni i Ankesave përbëhet nga:
 - Një (1) anëtar i Këshillit Akademik;
 - Një (1) anëtar i Këshillit të Etikës;
 - Një (1) anëtar, udhëheqës i shkollës përkatëse, i cili nuk ka qenë i përfshirë më parë në procesin e vlerësimit;
 - Një (1) përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

- 4. Procedimi i Vendimit:** Komisioni i Ankesave procedon vendimin lidhur me ankesën në Këshillin Akademik, i cili, bazuar në rekomandimet e Komisionit, ia propozon Rektorit miratimin e vendimit përfundimtar.

Prishtinë, 2024




Isabel Salvat
Drejtuës i Këshillit Akademik